



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-212 i Punes, Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.05/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**, shpall këtë:

KONKURS
për plotësimin e vendeve të punës

I.

Pozita:	Roje Sigurimi
Nr. i references:	AKSP-2/2016
Numri i vendeve të punës:	1 (një)
Koeficienti:	5
Orari i punes:	I plotë

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Vërteton vlefshmërinë e kartelës së identifikimit për të punësuarit dhe vijuesit e Akademisë, dhe pajis vizitorët me lejekalim për vizitor;
2. Kontrollon automjetet me rastin e hyrjes/daljes nga Akademia në përputhje autorizimet e dhëna në Rregulloren (AKSP) Nr.01/2015 për Sigurimin, qasjen dhe ruajtjen në Hapësirat e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
3. Regjistron personat, automjetet dhe mallrat që hyjnë/dalin nga Akademia dhe sigurohet që të gjitha aktivitetet zhvillohen në mënyrën e duhur në pajtim me rregullat e sigurimit;
4. Në rast të fatkeqësive, ndihmon kujdestarët në kontrollimin e zyrave dhe në evakuimin e të gjithë personave nga ndërtesa dhe siguron se të gjithë personat janë strehuar në vende të sigurta;

5. Në rast të fatkeqësive nga zjarri, bene aktivizimin e pajisjeve kundër zjarrit si dhe informon dhe drejton të gjithë personat në daljet emergjente, si dhe ofron ndihmën e parë personave të lënduar;
6. Kujdeset për sigurinë e objekteve dhe bënë patrulla dhe kontrole në të gjitha hapsirat e Akademisë;
7. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Udhëheqësi i Divizionit të Sigurimit të Hapësirave në Akademi.

Shkollimi dhe përvoja e kërkuar

- Diploma e shkollës së mesme (e obligueshme).
- Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).
- Se paku një (1) vite përvojë pune (e dëshirueshme).

Aftësia, dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, në programet Microsoft Word dhe Excel. Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor.

II.

Pozita:	Teknik/e i/e Lavanderisë
Nr. i references:	AKSP-3/2016
Numri i vendeve të punës:	1 (një)
Koeficienti:	5.5
Orari i punës:	I plotë

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Është përgjegjës për operimin e sigurt të të gjitha makinave larëse dhe tharëse të Lavanderisë në Akademi,
2. Bënë pranimin, pastrimin/larjen, tharjen, hekurosjen dhe deponimin e përkohshëm të rrobave;
3. Bashkëpunon ngushtë me zyrtaret e lavanderisë dhe zyrtarin e akomodimit, bën përgatitjen dhe inspektimin e dhomave të akomoduarëve në Akademi;
4. Raporton me kohë për defektet e ndodhura të pajisjeve dhe propozon servisimin e tyre;

5. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi dhe përvoja e kërkuar

- Diploma e shkollës së mesme (e obligueshme).
- Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).
- Se paku një (1) vite përvojë pune (e dëshirueshme).

Aftësia, dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, në programet Microsoft Word dhe Excel. Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor.

Kohëzgjatja e emërimit

Konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Periudha provuese gjashtë (6) muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 18.05.2015 deri me datën 01.06.2016, në ora 16:00.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, në Zyrën e Personelit. Kandidatet e interesuar aplikacionin mund ta shkarkojnë në adresën elektronike: <http://aksp.rks-gov.net/>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurrioni.

“Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.